

KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHËTITORES MIQËSIA"

*Njësitë të njëjta me origjinalin*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POLIÇAN  
AUTORITETI KONTRAKTOR

Adresa: Lagjia "Qender" Polican ; Tel:036824200 ; Email: njvbashkiapolican@gmail.com

Nr. 1125/16 Prot

Polican , me 4 .07.2016

## KONTRATË SIPËRMARRJE

OBJEKTI :

"REHABILITIMI I SHËTITORES MIQËSIA "

2016

## KONTRATË SIPËRMARRJE

### "Rehabilitimi i Shëtitorës Miqësia"

Lidhur sot me datë 04.07.2016 ne baze të nenit 850 dhe në vazhdim të Kodit Civil, ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike" dhe akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi midis:

- **Bashkise se Poliçanit** e përfaqësuar nga Z. Adriatik Zotkaj , Kryetar, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me adresë: Shëtitorja "Miqësia", Lagjia Qender, Polican, që më poshtë do të quhet "Autoriteti Kontraktor";  
dhe

**Bashkimit të operatoreve ekonomik "Ed- Konstruksion" shpk & "Totila" sh.p.k.**, regjistruar respektivisht si më poshtë shënuar:

Shoqëria "Totila" sh.p.k. regjistruar me Vendim Gjykatë Nr. 20816 datë 12.02.1999, me licencë profesionale të shoqërisë NZ. 3191/6, me vlefshmëri me afat kohor deri me 21.06.2021, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktura, me seli të shoqërisë: Berat, Barrikad, me NUIS K 13001010G e përfaqësuar nga Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë Z. Jemin Toto,

Shoqëria "Ed Konstruksion" shpk e regjistruar me Vendim Gjykatë; Nr. 33356, datë 12.04.2005 me licencë profesionale të shoqërisë NZ 4981/8, me vlefshmeri pa afat kohor, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktura, me seli të shoqërisë: Rruga "Frederik Shiroka". GV - Konstruksion, Kulla C, kati i II -16, Ap 1/2 Tirane, me NUIS K 61625001 I, e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor i shoqërisë Z. Alfred Ibrahim, i mëposhtë quajtur Kontraktor.

Shoqëria "Totila" sh.p.k dhe Shoqëria "Ed Konstruksion", me anë të aktmarreveshjes noteriale për bashkim të perkohshëm të operatoreve ekonomik të datës 15.06.2016 nr. 234 Rep Nr. 123 Kol dhe prokurës së posacme nr. 235 Rep nr. 124 kol kanë rënë dakort të bëjnë bashkimin e perkohshëm të shoqërive për realizimin e objektit "Rehabilitimi i shëtitorës miqësia ku shoqëria "Totila" sh.p.k "do të realizojë 40 % të zerave të punimeve dhe shoqëria, "Ed Konstruksion", sh.p.k do të kryejë 60 % të zerave të punimeve. Me anë të Prokurës së Posacme nr. 235 Rep nr. 124 kol të datës 15.06.2016, Shoqëria "Ed Konstruksion", sh.p.k. autorizon shoqërinë "Totila" shpk me Përfaqësues Ligjor z. Jemin Toto të jetë përfaqësues i bashkimit të perkohshëm të shoqërive në realizimin e objektit të Konhates, i më poshtë quajtur 'Kontraktor'.;

#### Neni I. Te pergjithshme ,



##### Neni 1.1 Objekti i kontrates

1.1 Objekti i kësaj kontrate është sipërmarrja me objekt: "Rehabilitimi i shëtitorës Miqësia" në përputhje të plote me projekt - zbatimin e objektit.

##### Neni 1.2 Vlera e kontrates

1.2 Kontrata lidhet me një vlerë totale prej 22 906 980 (njetzet e dy milion e nentëqind e gjashtë mijë e nentëqind e tetëdhjetë) leke pa tvsh dhe 27 488 376 (njetzet e shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë e tete mijë e treqind e shtatëdhjetë e

"TOTILA" sh.p.k.  
Nderimi Export - Export  
Nipt : K 13001010 G, Berat - Albania



## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

gjashte ) leke me tvsh . Vlera e financimit per vitin 2016 eshte **13 773 206 (trembedhjete milion e shtateqind e shtatedhjete e tre mije e dyqind e gjashte ) leke me tvsh** dhe diferenca e mbetur duke zbritur nga vlera totale e kontrates, shumen e likujduar do te shlyhet ne vitin 2017 , Fond i vënë në dispozicion nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve , granti i kushtezuar i infrastruktures vendore dhe rajonale , programi i zhvillimit vendor dhe rajonal shtylla I. Kontraktori merr persiper kryerjen e gjithe zerave te punimeve brneda afatit te levrimit 70 dite , ne te cilen do te bej dorezimin e punimeve brenda vitit kalendarik 2016 dhe pjesa e situacioneve do te likujdohet si me siper. Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontrates nuk duhet të ndryshojne nga çmimet e ofruara nga kontraktori në oferten e tij.

### Neni 1.3 Afati realizimit

1.3 Afati maksimal i përfundimit total te punimeve per ekzekutimin e gjithe zerave te preventivit eshte 70 dite kalendarik nga data e nenshkrimt te kontrates. Gjuha në të cilën përpilohet kontrata eshte Gjuha Shqipe.

### Neni 2: Përkufizime

- 2.1 "Preventiv total" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 "Preventiv per njesi" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 "Afati i realizimit te punimeve" do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 "Cmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 "Realizimi i punimeve" do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 "Defekt" do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 "Data e hyrjes" do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 "Data e fillimit" eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, data e fillimit "do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.




## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

- 2.10 "Pajisje" do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 "Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 "Drejtues projekti" do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 "Autoritet Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 "Kantier" do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 "Raport i inspektimit të kantierit" do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 "Kontraktor" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 "Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 "Ngritja e kantierit" do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.
- 2.22 "Punime" do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit

### Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.



## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

3.3 Te gjitha dokumentat e tenderit te dhena nga autoriteti kontraktor dhe te mara ne formen e ofertes nga kontraktori jane pjese perberse dhe integrale e kesaj kontrate.

### **Neni 4: Praktikate e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kerkoje gjykatës te deklaroje te paligjshme kontratën nese zbulon se kontraktori ka kryer veprime te korruptuara. Veprimet e korruptuara përfshijne veprimet e përshekruara ne Nenin 26 te Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktori nuk duhet te ketë lidhje (te tashme ose te shkuara) me asnje konsulent ose ent qe ka marrë pjesë ne pregatitjen e dokumentave te tenderit per këtë prokurim.

4.3 Kontraktori duhet te lejojë Autoritetin Kontraktor te inspektojë llogaritë dhe regjistrat qe kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me ane te kontrollorëve te emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet te mbajne ne konfidencë te gjitha dokumentat, te dhënat dhe informacionet e tjera te dhëna nga pala tjetër ne lidhje me kontratën.


5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta te tilla, te dhëna ose informacione te tjera qe merr nga Autoriteti Kontraktor deri ne masën e kerkuar qe nënkontraktorin te zbatojë punën e tij sipas kontratës. Ne rast te tillë, kontraktori duhet te përfshijë ne kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë qe premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet ne Paragrafin 5.1 me sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

6.1 Me përjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kontratë, te gjitha te drejtat e pronës intelektuale te siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit te kontratës do t'i perkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i perdorë ato sipas gjykimit te tij.

6.2 Me përjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kontratë, kontraktori, pas përfundimit te kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor te gjitha raportet dhe te dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit te kontratës. Kontraktori mund te mbajë kopje te këtyre dokumentave dhe te dhënave, po nuk duhet t'i perdori per qëllime qe s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

6.3 Kontraktori duhet te garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia per shkelje te te drejtave te pronës intelektuale, qe mund te dalin nga perdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.



## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

### Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

### Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

### Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

### Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit të punimeve.

### Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

### Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

**"TOTIDA" Sh.p.k.**  
Ndërtim Import - Export  
Njësitë K 13601010 G, Berat - Albania



*[Handwritten signature]*

## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

### Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

### Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

### Neni 15: Ngritja e Kantierit

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.


### Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

### Neni 17: Zbulimet

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë



Handwritten signature and circular stamp.

## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITËS MIQËSIA"

dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

### Neni 18: Disponimi i Kantierit

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

### Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

### Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

### Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.



21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

### Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi





## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

### Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/ kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

### Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

### Neni 25: Sigurimi

25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.


25.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

### Neni 26: Testimet dhe Inspektimet

26.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspekteve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës

26.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspekte.

26.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund të kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspekte shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të



## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORËS MIQËSIA"

nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

26.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

26.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

### Neni 27 Garancitë

27.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

27.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

27.3 Garancia e difekteve do të jetë 5 % e vlerës së kontratës që do të mbahet nga çdo situacion. Kontraktorit si garanci për cilësinë e punimeve, shume e cila do të paguhet mbas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve, duke marrë parasysh edhe sanksione e parashikuara në kontratë.

### Neni 28: Çmimi i Kontratës




28.1 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

### Neni 29: Kushtet e Pagesës

29.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.

29.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

29.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqesë një deklaratë me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është përbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe






## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korrigjimit të një defekti.

- 29.4 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.
- 29.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.
- 29.6 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.
- 29.7 Pagesa e situacioneve do të kryhet në llogarinë bankare pranë Bankes Kombetare Tregtare me kod IBANI AL 3420523132137432CLPRCLALLJ .
- 29.8 Financimi i objektit me fonde të vena në dispozicion në mbeshtetje të vendimit nr.10 date 10.03.2016 granti i kushtezuar i infrastruktures vendore dhe rajonale , programi i zhvillimit vendor dhe rajonal shtylla I.
- 29.9 Pagesa e situacioneve do të kryhet sipas financimit të parashikuar në pikën 1.2 të nenit 1 të kësaj kontrate.

### Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës

- 30.1 Shperblimi për demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.
- 30.2 Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori ( kontraktori) të provojë ndonjë dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor ) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.
- 30.3 Rastet e kompensuara për të cilën vonesa në pagesë justifikohet do të konsiderohen si vijon:
- Mbikqyresi i Punimeve urdheron shtyrjen ose nuk jep skicat (vizatimet) specifike ose udhëzimet e nevojshme për kryerjen e punimeve në kohën e caktuar.
  - Mbikqyresi i Punimeve udhëzon Kontraktorin për të zbuluar punimet e fshehta ose për të kryer provat pas kryerjes së punimeve.
  - Autoritet Publikë ose Autoriteti Kontraktor shkaktojnë vonesa në lirim të sheshit të ndërtimit për Kontraktorin.
  - Autoriteti Kontraktor vonon pa arsye lëshimin e certifikates së marrjes në dorezim.
- 30.4 Kompensimi i rasteve të sipërpermendura do të bëhet si vijon:  
Për vonesat e permendura në pikat 30.3 (a,b,c,d) Autoriteti Kontraktor do të njohtë shtyrjen e datës së përfundimit të punimeve mbi ato të parashikuar në këtë kontratë.



**Neni 31: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

31.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 32: Forca Madhore**

32.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

32.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

32.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

**Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**



33.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

33.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

33.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

33.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

33.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është



## KONTRATË SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

### Neni 34: Dëmet e Likuidueshme për Vonësën në Mbarimin e Punimeve

34.1 Dëmet e likuidueshme për vonësën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

### Neni 35: Negociatat dhe Amendamentet

35.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.

35.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

35.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.



### Neni 36: Ndryshimi i Porosisë

36.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

36.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit original të kontratës.

36.3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi



Handwritten signature and date 16.

## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

36.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

36.5 Ndryshimi i porosise nuk do te jete i vlefshem nese nuk formalizohet sipas kerkesave te Nenit 35 te ketyre kushteve te pergjithshme.

### Neni 37: Preventivi për Njësi ose në Total

37.1 Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njësi nëse është një kontratë me çmim njësie. Nëse është një kontratë me çmim njësie, preventivi për njësi do të përmbajë volumet e zërave të ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

37.2 Preventivi për Njësi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

### Neni 38: Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve

38.1 Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.



38.2 Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerrat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

38.3 Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

38.4 Demtimi i punimeve ose humbja e materialeve që do të përdoren për punimet nga dita e fillimit deri në marjen në dorezim si dhe gjatë afatit të garancisë së difekteve do të mbulohet nga Kontraktori me shpenzimet e tij neqoftese humbja ose demtimi janë shkaktuar nga gabimet e veprimeve të tij.

38.5 Riparimet që dalin të nevojshme gjatë kolaudimit të veprës, nëse janë për shkak të mosplotësimit të kontratës ose të punës jo cilësore të Kontraktorit do të mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.

38.6 Mbas marrjes së gjithë dokumentacionit Autoriteti Kontraktor i paraqet komisionit të kolaudimit gjithë dokumentacionin e realizimit të objektit. Me përfundimin e procedurave të kolaudimit Autoriteti Kontraktor lëshon certifikatën e marrjes në dorezim të punimeve të kryera dhe do të cilrojë garancinë e sigurimit të Kontratës. Nga data e akt-kolaudimit të punimeve fillon periudha e garancisë së punimeve.



## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

38.7 Ne fund të periudhës së garancisë së punimeve, Mbikqyresit i Punimeve dhe komisioni i manjës në dorezim të objektit do të përpilojnë së bashku me Autoritetin Kontraktor aktin për manjës në dorezim të veprës, objekt i kësaj kontrate.

### Neni 39: Ndërprerja për Mosplotësim

39.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

39.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japë kontraktorit 15 ditë të ndreqjeve mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

39.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj

### Neni 40: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

40.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

40.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

### Neni 41: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik



41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

41.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesëve të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

### Neni 42: Nënkontraktimi

42.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrëveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.



## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

- 42.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacinin që provon aftësinë e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
- 42.3 Cdo nenkontraktor duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për punët që do të kryejë
- 42.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

### Neni 43: Transferimi i të Drejtave

- 43.1 Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

### Neni 44: Sigurimi i Kontrates



- 44.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet të dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar . Konkretisht në shumën: 2 748 837.6 ( dy milion e shtateqind e dyzete e tet mijë e tetqind e tridhjetë e shtate pike gjashtë ) leke e pranueshme sic specifikohet në kontratë. Dështimi për të dhënë sigurimin e kontrates në formën dhe në shumën e kërkuar brenda 30 diteve do të rezultoi në anulimin e kontrates dhe humbjen e sigurimit të ofertes të kontraktorit.
- 44.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet të paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 44.3 Sigurimi i kontrates do të kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

### Neni 45: Baza Ligjore

- 45.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

### Neni 46: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

- 46.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.
- 46.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.





## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

### Neni 47: Përfaqsimi i Palëve

- 47.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.
- 47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 47.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

### Neni 48: Lajmërimet

- 48.1 Çdo lajmërim, komunikim, njoftim, miratim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë, nëse ka ndryshim të adresës palet janë të detyruar të njoftojnë për çdo ndryshim.


### Neni 49: Llogaritja e Afateve

- 49.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

### Neni 50: Mbikqyesi i Punimeve

- 50.1 Mbikqyesi i punimeve për realizimin e kontratës me objekt; Rehabilitimi i shetitores Miqësia do të jetë ARENA MK përfaqësues Endrit Myrtaj " referuar kontratës së lidhur 04.07.2016 midis z. endrit Myrtaj dhe Bashkisë Polican në cilësinë e Autoritetit Kontraktor. Detyrat e mbikqyresve të punimeve burojnë nga aktet ligjore dhe n/ligjore në fuqi dhe janë të detajuara në kontratën e shërbimit të lidhur me këta të fundit.
- 50.2 Në rast se mbikqyesi do të ndryshohet Autoriteti Kontraktor njofton menjëherë Kontraktorin.
- 50.3 Mbikqyesi i Punimeve do të vendoset për çështjet e kontratës midis Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 50.4 Mbikqyesi i Punimeve mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij të tjeret përveç zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe konflikteve. Mbikqyesi i punimeve duhet të njoftojë me shkrim Kontraktorin për delegimet e bera apo të deleguara.
- 50.5 Mbikqyesi i punimeve duhet të kontrollojë Punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.
- 50.6 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa periodike për punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga mbikqyesi i punimeve.

### Neni 51. Personeli i Kontraktorit



## KONTRATE SI PERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

51.1 Kontraktori është i detyruar të punësojë në kantier për kryerjen e funksioneve të parashikuara në programin e miratuar nga Mbikqyresia i punimeve vetëm personelin inxhinierik të deklaruar në ofertë.

51.2 Mbikqyresia i Punimeve do të propozojë Autoritetit kontraktor për të zëvendësuar personelin kryesor vetëm nëqoftëse kualifikimet dhe aftësitë e tyre të nevojshme janë baraz ose më të larta se ato të personelit të përcaktuar në ofertën e Kontraktorit.

51.3 Në qoftë se Mbikqyresia i Punimeve i kërkon Kontraktorit që të largojë një person, i cili është anëtar i personelit ose i fuqisë punëtore të Kontraktorit, duhet të theksuar arsyeja. Kontraktori do të marrë masë për të siguruar që personi në fjalë të largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 orëve dhe të mos ketë me lidhje me punën e përfshirë në kontratë.

51.4 Kontraktori është i detyruar të caktojë Drejtorin Teknik. Drejtori teknik është personi që Kontraktori ka përcaktuar në ofertën e tij. Drejtuesit Teknik të punimeve të objektit do të jete inxh. ndertimi Alma Mbrati i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë "Totila" shpk, me NZ. 3191/6, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktura.

Detyrat e Drejtorit Teknik të Punimeve janë si më poshtë:



- a) Zbatimin e objektit konform projektit dhe kushteve teknike të zbatimit
- b) Të jete i pranishëm gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve në kantier;
- c) Të jete i pranishëm dhe të përfaqësojë Kontraktorin në të gjitha kontaktet, takimet zyrtare apo mbledhjet që Autoriteti Kontraktor zhvillon me Kontraktorin dhe Drejtorin e Projektit në zgjidhjen e diskutimit dhe ceshtjeve teknike e profesionale që lindin gjatë zbatimit të punimeve;
- d) Është përgjegjës për dokumentacionin teknik që është i detyrueshëm të mbahet në objekt;
- e) Mban Korrespondencën zyrtare me Mbikqyresinë e punimeve;
- f) Është përgjegjës për ecurinë e zbatimit të punimeve konform plan organizimit dhe grafikut të punimeve;
- g) Është i pranishëm në të gjitha fazat e realizimit të objektit: zbatimin e punimeve, dorëzimin dhe kolaudimin e objektit.

51.5 Në rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik, Kontraktori duhet detyrimisht të lajmërojë Mbikqyresinë e Punimeve i cili ve në dijeni Autoritetin Kontraktor.

51.6 Drejtuesi teknik në këtë rast duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për Drejtuesin teknik. Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë emërimin e Drejtuesit Teknik nëse vlerëson se ai nuk përmbush kualifikimet e përcaktuara në Dokumentat e tenderit. Në këtë rast Kontraktori cakton një Drejtues teknik tjetër dhe detyrimisht lajmëron Mbikqyresinë e Punimeve i cili ve në dijeni Autoritetin Kontraktor.

### Neni 52 : Taksat

52.1 Kontraktori është i detyruar të paguajë të gjitha taksat në përputhje me Legjislacionin Shqiptar. Për taksat e përcaktuara në legjislacionin që ka hyrë në fuqi 28 ditë para datës së hapjes së tenderit, të cilat Kontraktori duhet të ketë marrë parasysh në vlerën e kontratës. Autoriteti Kontraktor nuk do të njohë asnjë shtesë pagesë.



## KONTRATE SIPERMARRJE "REHABILITIMI I SHETITORES MIQËSIA"

52.2 Nese Kontraktori nuk eshte i rregjistruar si subjekt qe ushtron aktivitet ne qytetin e Policanit eshte i detyruar te shlyeje ato taksa dhe tarifa vendore qe kane te bejne me realizimin e aktivitetit te perkohshem ne qytetin e Policanit .

### Neni 53: Zgjidhja e kontrates.

53.1 Autoriteti Kontraktor ose Kontraktori mund te pezulloje kontraten kur veren shkelje themelore te saj .

53.2 Shkeljet themelore te kontrates perfshijne por nuk kufizohen ne sa vijon:

- Kontraktori nuk fillon pune brenda 5 diteve nga fillimi i zbatimit te kontrates si dhe ne rastet kur ndalohen punimet me shume se 10 dite kur nuk parashikohet ne programin e punes dhe ndalimi i punimeve nuk eshte i autorizuar nga Mbikqyresi i Punimeve dhe nuk respektohet grafiku i punimeve.
- Mbikqyresi i Punimeve udhezoi pezullimin e punimeve duke njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Kontraktorin.
- Kontraktori falimenton ose fillon likuidimin per arsye te tjera pervec rindertimit ose bashkimit te shoqerise.
- Kontraktori vonon kryerjen e punimeve dhe nuk realizon korigjimet e difekteve te propozuara nga Mbikqyresi i Punimeve.
- Autoriteti Kontraktor mund te nderpresd kontraten per shkak te Interesit Publik, ne cdo kohe nese gjykon se ky veprim duhet ndermarr per ti sherbyer me mire interesit publik.

### Neni 54 Pagesa pas Zgjidhjes se Kontrates

54.1 Ne rast se kontrata priset nga Autoriteti Kontraktor per arsye objektive, Mbikqyresi i Punimeve do te leshoje nje certifikate per vleren e punes se kryer duke zbritur pagesat e marra deri ne ditën e leshimit te Certifikates.

### Neni 55. Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

55.1 Nese pas dates se nenshkrimet te kontrates, ndonje ligj, rregullore, urdherese, urdher ose procedure me efektin e ligjit ne Republiken e Shqiperise hyn nd fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke perfshire daten e dorezimit, ose cmimin e ekushtet ose cmimi i kontrates do te negullohen ne ate mase sa kontraktori eshte ndikuar ne permbushjen e detyrimeve te tij sipas kontrates.

### Neni 56. Dispozita te Fundit

56.1 Kjo kontrate do te quhet e vlefshme duke filluar nga data e nenshkrimet te saj nga te dy palet. Te gjitha referencat e diteve do te jene kalendarike. Pjese perberse e kontrates jane gjithë dokumentat e tenderit, dhe dokumentat e operatorit ekonomik, oferta, grafiku i punimeve dhe ndarja e zerave te preventivit sipas perqindjes se pjesemarrjes.

Kjo kontrate perbehet nga 19 nentembedhete flete, u hartua ne 6 (gjashte) kopje, kater nga te cilat i mban Autoriteti Kontraktor dhe dy kopje i mban Kontraktori.

**KONTRAKTORI :**  
"TOTILA" SHPK & "ED KONSTRUKSION" SHPK

**AUTORITETI KONTRAKTOR:**  
BASHKIA POLICAN

PERFAQESUESI LIGJOR

JEMIN TOTO  
Nipt : K 13001010 G, Berat - Albania

ALFRED I BRAHIMI



TITULLARI  
AUTORITETIT KONTRAKTOR  
ADRIATIK ZOTKAJ